

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Fejzullah Rexhepi kryetar, Ramë Hyseni dhe Albert Zogaj anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit Xh.D. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit të vërtetuar në Gjykatë, e përfaqëson Z.G., kundër të paditurit N.LL., nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, me vendbanim në Smederve, R. Serbisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson D.L., avokat nga ..., me bazë juridike vërtetim pronësie, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1832/06 të datës 02.04.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **31.01.2018**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të autorizuarit të paditësit Xh.D., nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1832/06 të datës 02.04.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1832/06 të datës 02.04.2013, në pikën një të dispozitivit të saj, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit Xh.D., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi është pronar i paluajtshmërive të regjistruara si ngastra nr.1046, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Livadhe, kl.4, në sipërfaqe prej 0.41.25 ha, ngastra kadastrale nr.1047, vendi i quajtur “NN”, me kulturë “Mal”, kl.3, në sipërfaqe prej 3.44.04 ha, dhe ngastra kadastrale nr.1048, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Gremin, kl.0, në sipërfaqe prej 0.06.81 ha, të gjitha të evidentuara sipas fletës poseduese, nr.45, KK- ..., dhe të detyrohet i padituri që paditësit të ia njoh të drejtën e pronësisë mbi këtë patundshmëri, si e pa bazuar. Në pikën dy, vihet jashtë fuqie pasi që aktgjykimi të marrë formën e prerë, masa e sigurimit, e caktuar me aktvendimin E.nr.1304/06, e datës 18.04.2007. Në pikën tre, detyrohet paditësi që të paditurit të ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 987 €.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të merr vendim që këtë ankesë ta aprovojë si të bazuar, të ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1832/06, të datës 02.04.2013, ta aprovon si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Xh.D., nga Prishtina, duke vërtetuar se i njëjti është pronar i paluajtshmërive të regjistruara si ngastra nr.1046, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Livadhe, kl.4, në sipërfaqe prej 0.41.25 ha, ngastra kadastrale nr.1047, vendi i quajtur “NN”, me kulturë “Mal”, kl.3, në sipërfaqe prej 3.44.04 ha, dhe ngastra kadastrale nr.1048, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Gremin, kl.0, në sipërfaqe prej 0.06.81 ha, të gjitha të evidentuara sipas fletës poseduese nr.45, KK- ..., dhe detyrohet i padituri që paditësit të ia njoh të drejtën e pronësisë mbi këtë patundshmëri.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi më datë 04.10.2006, ka ushtruar padi ndaj të paditurit, për vërtetimin e pronësisë, me propozim që të aprovohet kërkesëpapia e paditësit, të vërtetohet se paditësi Xh.D. nga Prishtina, është pronar i patundshmërive të regjistruara si ngastra kadastrale nr.1046, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Livadhe, kl.4, në sipërfaqe prej 0.41.25 ha, ngastra kadastrale nr.1047, vendi i quajtur “NN”, me kulturë “Mal”, kl.3, në sipërfaqe prej 3.44.04 ha, dhe ngastra kadastrale nr.1048, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Gremin, kl.0, në sipërfaqe prej 0.06.81ha, të gjitha të evidentuara sipas fletë posedimit nr.45, KK- ..., dhe detyrohet i padituri që paditësit të ia njoh të drejtën e pronësisë mbi këtë patundshmëri. Obligohet Drejtoria Gjeodete në Prishtinë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, t’i bënë ndërrimet në librat kadastrale. Me aktvendimin E.nr.1304/06, të datës 18.04.2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, ka caktuar masën e përkohshme ndaj L.N., nga Prishtina.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, vendosi sikurse në dispozitiv të saj, duke e refuzuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, vendimin e saj e mori konform nenit 20, 28 par.2, të LTHMPJ-së, nenit 26, 73 të LMD-së, nenit 402 par.1 të LPK-së, dhe nenit 4 par.2, të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, (Gaz. Zyrtare e RS, nr.43/81, 24/85, 6/89, 30/89, dhe 40/89, i zbatueshëm sipas nenit 1 par.1/b, të Rregullores së UNMIK-ut, r.1999/24, të datës 12.12.1999, dhe par.2 të këtij neni), duke vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet për vërtetimin e të drejtës së pronësisë së paditësit në raport me të paditurin, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e mori konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë, për të vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, administroi dhe vlerësoi këto prova, bëri leximin e fotokopjes së kontratës të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurit, me datë 07.08.1996, leximin dhe mendimin e konstatimit të dhënë nga ana e ekspertit të gjeodezisë në ekspertizën e datës 07.10.2010, leximin e mendimit dhe konstatimit të dhënë në raportin e ekspertizës të Sektorit për ekspertim të dokumenteve dhe dorëshkrimeve të punuar nga Ministria e Punëve të Brendshme- Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me leximin e deklaratave me shkrim të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me VR.nr.4286/2007, të datës 16.05.2007, të dhënë nga SH.SH. nga Prishtina dhe H.G. nga Prishtina, me VR.nr.47/91 të datës 31.05.2007, prandaj vendosi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për të cilat është thirrur pala në ankesë si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike duke refuzuar kërkesëpadinë e palës paditëse, me të cilën ka kërkuar “që të vërtetohet se paditësi është pronar i paluajtshmërive të regjistruara si ngastra nr.1046, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Livadhe, kl.4, në sipërfaqe prej 0.41.25 ha, ngastra kadastrale nr.1047, vendi i quajtur “NN”, me kulturë “Mal”, kl.3, në sipërfaqe prej 3.44.04 ha, dhe ngastra kadastrale nr.1048, vendi i quajtur “NN”, me kulturë Gremin, kl.0, në sipërfaqe prej 0.06.81 ha, të gjitha të evidentuara sipas fletës poseduese, nr.45, KK- ..., dhe të detyrohet i padituri që paditësit të ia njoh të drejtën e pronësisë mbi këtë patundshmëri”, pasi nga provat e administruara paditësi nuk ka mundur të provon se ka fituar të drejtë e pronësisë në paluajtshmërinë sipas kërkesë padisë, në një nga format që përcakton neni 20 i Ligjit Mbi Marrëdhëniet Juridiko- Pronësore. Prezantimi i kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë të datës 07.08.1996, të lidhur në mes të N.LL. si shitës dhe Xh.D. si blerës, nuk paraqet provë në bazë të së cilës mund të vërtetohet e drejta e pronësisë, e njëjta kontratë është kontestuar nga pala e paditur se asnjëherë nuk është nënshkruar nga ana e tij, paditësi ka dështuar që të njëjtën kontratë Gjykatës të ia ofrojë në origjinal, në mënyrë që e njëjta të jetë e përshtatshme për tu kryer ekspertiza grafologjike për ekzaminimin e nënshkrimit dhe shenjave të gishtit, për të vërtetuar faktin nëse nënshkrimi dhe shenjat e gishtit kanë qenë të paditurit, pasi edhe laboratorit i forenzikës në bazë të provave të prezantuara nuk ka mundur ta vërtetoj faktin nëse nënshkrimi dhe shenjat e gishtit kanë qenë të t ‘paditurit N.LL.. Paditësi ndonëse ka pretenduar se ka paguar çmimin kontraktues prej 200.000 dm, nuk i ka ofruar ndonjë provë Gjykatës me të cilën do ta bënte të besueshëm këtë fakt.

Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk i ka marrë si prova të besueshme deklaratat e dëshmitarëve SH.SH. të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, VR.nr.486 të datës 16.05.2007, dhe të dëshmitarit H.G. VR.nr.4791 të datës 31.05.2007, pasi të njëjtit dëshmitarë nga pala paditëse nuk janë propozuar që të dëgjohen në cilësinë e dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë që të zbatohet parimi i kontradiktoritetit dhe të kenë mundësinë që palët në procedurë por edhe Gjykata t’iu parashtrij pyetje dhe të kërkojë sqarime për deklaratimet e tyre, ndërsa pretendimet se Gjykata nuk ua fali besimin është dashur që ti ftojë në seancë, është i pa bazuar, pasi nga vet fakti që pala e paditur e ka kontestuar vlefshmërinë e këtyre deklaratave, pala paditëse është dashur që të propozoj dëgjimin e tyre në cilësinë e dëshmitarit, por që një propozim i tillë nuk është bërë.

Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet për të i njohur paditësit të drejtën e pronësisë, paluajtshërinë lëndore, siç kërkohet me dispozitat e neneve 20, 28 par.2, të LTHMPJ-së, dhe nenit 4 par.2, të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, (Gaz. Zyrtare e RS, nr.43/81, 24/85, 6/89, 30/89, dhe 40/89, i zbatueshëm sipas nenit 1 par.1/b, të Rregullores së UNMIK-ut, r.1999/24, të datës 12.12.1999, dhe par.2 të këtij neni), pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me fitim të pronësisë, me ndonjë nga format e parapara me nenin 20 të LTHMPJ-së, po ashtu nuk kemi të bëjmë me parashkrim fitues, në bazë të nenit 28 par.2 të LTHMPJ-së, sepse paditësi në asnjë mënyrë me provat e prezantuara dhe të administruara në këtë çështje se paluajtshmërinë

lëndore e ka pasur në posedim të ligjshëm dhe mirëbesim për më tepër se 10vite, që është kusht për aplikimin e kësaj dispozite. Po ashtu nuk janë plotësuar kushtet sipas nenit 4 par.2, të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, (Gaz. Zyrtare e RS, nr.43/81, 24/85, 6/89, 30/89, dhe 40/89, i zbatueshëm sipas nenit 1 par.1/b, të Rregullores së UNMIK-ut, r.1999/24, të datës 12.12.1999, dhe par.2 të këtij neni), në bazë të cilit kërkohet që kontrata mbi Qarkullimin e Paluajtshmërive të jetë e legalizuar nga organi kompetent, në rastin konkret nga Gjykata, që nuk kemi të bëjmë me kontratë të shitblerjes e cila i plotëson kushtet sipas këtyre dispozitave, por Gjykatës i është ofruar vetëm një kontratë kopje, të cilën i padituri mohon ta ketë lidhur dhe nënshkruar.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e paditësit si në ankesë janë në tërësi të pa bazuara, pretendimi se paditësi ka fituar pronësinë në bazë të kontratës së shitblerjes të lidhur në vitin 1996, në kuptim të nenit 73 të LMD-së, pasi kjo kontratë nuk ka mundur të legalizohet për shkak të ndalesës së shitblerjes dhe legalizimit të kontratave ndërmjet serbëve dhe shqiptareve në vitet e 90- ta, është pretendim i pa bazuar, për faktin se kontrata e prezantuar është në kopje, vetë fakti se i padituri nuk e pranon lidhjen dhe nënshkrimin e saj, nuk paraqet provë në bazë të cilës gjykata mund të bazoj vendimin e saj, ndërsa nga shkresat e lëndës të administruara në këtë çështje nuk mund të provohet se e njëjta kontratë është lidhur dhe nënshkruar nga i padituri, dhe nëse obligimet dhe të drejtat nga kjo kontratë janë përmbushur.

Gjykata ka vlerësuar pretendimin ankimor lidhur me shpenzimet, por vlerëson se Gjykata ka aplikuar drejtë dispozitën e nenit 452 të LPK-së, ashtu që ka detyruar paditësin që të paditurit të ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 987 €, pasi të njëjtat shpenzime janë krijuar bazuar në shkresat e lëndës.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3529/13, me datë 31.01.2018

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Fejzullah Rexhepi